



Republika e Kosovës	Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit	Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution
Nr./Br./No.	<u>1873/2021</u>
Nr.i fq/Br.str./Nr.pg.	
Data/Datum/Date:	<u>02/12/21</u>
PRISHTINË • PRISTINA • PRISTINA	



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

**MENDIM JURIDIK I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
NË CILËSINË E MIKUT TË GJYKATËS (AMICUS' CURIAE)**

drejtuar

**Gjykatës Themelore në Prishtinë
Departamenti i Përgjithshëm**

A.nr.738/2020

Faruk Kukaj

në lidhje me Padinë C.nr.3663/18 kundër Komunës së Prishtinës

përkitazi me pretendimet për diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, respektivisht mosrespektimin e dispozitave ligjore lidhur me krijimin e kushteve të përshtatshme fizike për personat me aftësi të kufizuar në hapësirat publike dhe private në komunën e Prishtinës

Prishtinë, më 2 dhjetor 2021

QËLLIMI

1. Ky Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) do të përqendrohet në sqarimin e bazës dhe analizës ligjore përkitazi me ankesën e z. Faruk Kukajt, drejtor i organizatës Handikos në Prishtinë dhe shfrytëzues i karrocës elektrike si mjet për lëvizje, i cili parashtrroi ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) kundër Komunës së Prishtinës, përkitazi me padinë e parashtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë (GjThP), e datës 12 dhjetor 2018, me numër të lëndës C.nr.3663/18, me pretendimet për diskriminim, në bazë të aftësisë së kufizuar, gjegjësish për mosrespektimin e dispozitave ligjore lidhur me krijimin e kushteve të përshtatshme fizike në hapësirat publike në komunën e Prishtinës për personat me aftësi të kufizuar.
2. Prandaj për këtë qëllim Avokati i Popullit ia paraqet GjThP-së këtë mendim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*).

BAZA LIGJORE E VEPRIMIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 1, përcakton: “*Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*”
4. Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 9, përcakton: “*Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi.*”
5. Nenin 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, përcakton: “*Avokati i Popullit ka përgjegjësi t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.*”

PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES

6. Më 17 dhjetor 2020, Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.1 të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga z. Faruk Kukaj, drejtor i organizatës Handikos në Prishtinë dhe shfrytëzues i karrocës elektrike si mjet për lëvizje, parashtruar kundër Komunës së Prishtinës lidhur me padinë e parashtruar në GjThP, me pretendimet për diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, gjegjësish për mosrespektimin e dispozitave ligjore lidhur me krijimin e kushteve të përshtatshme fizike në hapësirat publike në komunën e Prishtinës për personat me aftësi të kufizuar.
7. Ankuesi ka thënë se ai është person me aftësi të kufizuar dhe ka shumë vështirësi për të lëvizur nga një vend në tjetrin, përfshirë rrugën “Sylejman Vokshi” në Prishtinë, ku ai jeton, e deri në vendin e tij të punës në rrugën “28 Nëntor” në Prishtinë. Po ashtu ankuesi ka pohuar se vështirësi për lëvizje ai ka edhe për t'i kryer nevojat për përkujdesje të shëndetit të tij, për t'i marrë shërbimet shëndetësore në qendra familjare shëndetësore, për t'i kryer shërbimet dhe detyrimet ndaj shërbimeve komunale (pagesa për energjinë elektrike, mbeturinat, ujin etj.), për aktivitete të tjera që kanë të bëjnë me nxjerrjen e dokumentacioneve të nevojshme personale në Komunë, për të bërë edhe vizita mjekësore, për të dalë me miq apo me të afërm të tjerë të familijs.

8. Sipas pohimeve të ankuesit, Komuna e Prishtinës nuk është duke zbatuar Ligjin nr.04/L-110 për Ndërtim, i cili ka për qëllim përcaktimin e kornizës ligjore, e cila rregullon lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmërinë me kërkesat e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda territorit të Republikës së Kosovës. Gjithashtu ankuesi ka pohuar se në Komunën e Prishtinës, infrastruktura rrugore dhe objekteve e dedikuar për publik nuk i plotëson kushtet dhe standarde përcaktuara në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar¹, përkatësisht nenin 7 (Elementet Obligative për Qasje, pika 1), i cili përcakton: “*I) Elementet obligative për qasje janë: A. elementet për qasjen në nivele me lartësi të ndryshme; B. elementet e qasjes për jetë të pavarur; C. elementet për qasje në komunikacion publik.*”
9. Më 12 dhjetor 2018, ankuesi z. Faruk Kukaj kishte parashtruar padi në GjThP, Departamenti i Përgjithshëm, kundër Komunës së Prishtinës, me pretendimet për diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, gjegjësisht për mosrespektimin e dispozitave ligjore lidhur me krijimin e kushteve të përshtatshme fizike në hapësirat publike në komunën e Prishtinës për personat me aftësi të kufizuar, me numër të lëndës C.nr.3663/18.
10. Më 20 janar 2021, në GjThP është mbajtur seanca përgatitore lidhur me rastin e ankuesit, në të cilën është marrë aktvendim që i autorizuari i paditësit (ankuesit), në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta rregullonte padinë në kuptimin objektiv, ashtu që t'i sqaronte veprimet diskriminuese për të cilat kërkonte që të ndaloheshin dhe të

¹ Më 29 janar 2021, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, përmes postës elektronike, ka kërkuar informata nga udhëheqësja e Departamentit Ligjor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Planifikimit Hapësinor (MEPH), përkitazi për këtë akt nënligjor, pasi bazë ligjore e nxjerrjes së këtij akti është Ligji nr.2004/15 për Ndërtim, i cili është shfuqizuar me Ligjin nr.04/L-110 për Ndërtim. Megjithatë, sipas ligjit të fuqi për Ndërtim, nuk ka ndonjë akt nënligjor të veçantë që ka të bëjë me kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuar. Gjithashtu Ligji për Ndërtim, që është në fuqi, në kuadër të dispozitave kalimtare, shprehimisht nuk përcakton shfuqizimin e Udhëzimit Administrativ nr.33/2007, kurse në parim, me shfuqizimin e ndonjë ligji, shfuqizohen edhe aktet e tjera nënligjore. Prandaj për çështjen e lartpërmendor, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka kërkuar një opinion nga MEPH-ja përkitazi me atë se Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar a mund të konsiderohej në fuqi apo mbi çfarë baze ligjore mund të mbështeteshin personat me aftësi të kufizuara për të kërkuar respektimin e të drejtave të tyre kur bëhet fjalë për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuar. Më 3 shkurt 2021, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, përmes postës elektronike ka marrë kërkesë përtakim nga udhëheqësja e Departamentit Ligjor në MEPH, e cila ka propozuar takim me përfaqësuesit e IAP-së dhe të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, i cili takim është mbajtur më 8 shkurt 2021, por pas shqyrtimeve të ndryshme ligjore, janë pajtuar që përgjigjja përkitazi me çështjen në fjalë të dërgohej në IAP përmes postës elektronike nga MEPH-ja. Më 15 shkurt 2021, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit sërisht i ka dërguar shkresë përsëritëse udhëheqëses së Departamentit Ligjor në MEPH lidhur me kërkesën për opinion për rastin në fjalë. Më 19 mars 2021, përfaqësuesi i MEPH-së ka dërguar përgjigje tek IAP-ja, sipas së cilës, Udhëzimi Administrativ Nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar figuron në listën e akteve nënligjore në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ndërsa sa i përket çështjes se mbi çfarë baze ligjore mund të mbështeteshin personat me aftësi të kufizuara për të kërkuar respektimin e të drejtave të tyre kur bëhet fjalë për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuar, ka njoftuar se neni 38, paragrafi 3, i Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtimin, neni 17, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2.6, i Udhëzimit Administrativ Nr.06/2017 për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrënim i përkategorinë I dhe II, si dhe pika 10 e Shtojcës nr. 8 të këtij udhëzimi administrativ përcaktojnë bazën ligjore sa i përket kësaj çështjeje. Pra, bazuar në regjistrin e akteve nënligjore të qeverisë dhe të ministrite, e publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në faqen 220, me nr. rendor 1933, në fuqi është Udhëzimi Administrativ Nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar.

eliminohen nga Komuna e Prishtinës, në cilësinë e së paditurës. Po ashtu gjykata ka kërkuar të bëhej rregullimi i kërkesëpadisë sa i përket kërkesës për dëmin material dhe jomaterial, ashtu që të saktësohej se për çfarë kategorie të dëmit parashtrohej kërkesa si dhe të ofroheshin prova apo të propozoheshin mjete provuese për vërtetimin e fakteve në këto kategori të dëmit. Në këtë seancë gjyqësore, sipas kërkesës së ankuesit, ka marrë pjesë edhe përfaqësuesi i IAP-së, në cilësinë e monitoruesit.

11. Më 25 janar 2021, në GjThP ankuesi e ka dorëzuar saktësimin dhe rregullimin e padisë në kuptimin objektiv.
12. Më 11 shkurt 2021, në GjThP është mbajtur seanca përgatitore lidhur me rastin e ankuesit si dhe është aprovuar propozimi i të autorizuarit të paditësit (ankuesit) për nxjerrjen e provës nga lëmi i ndërtimtarisë, makinerisë dhe psikiatrisë. Gjyqtari i rastit ka kërkuar nga i autorizuari i paditësit (ankuesit) që t'i përcaktonte lokacionet në të cilat ai haste në probleme për t'u qasur fizikisht, në mënyrë që të bëhej evitimi i mundshëm i pengesave, në rast se merret vendim gjyqësor në favor të paditësit dhe se i autorizuari i paditësit (ankuesit) ka përcaktuar disa nga rrugët publike dhe të kompanive të tjera private, në të cilat pretendonte se nuk i plotësonin standardet e ndërtimit për qasje për ankuesin, si person me aftësi të kufizuar.

BAZA LIGJORE

13. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), neni 3, paragrafi 2, Barazia para Ligjit, përcakton: “*Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.*”
14. Neni 24, Barazia para Ligjit, përcakton:
 - “1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
 2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë [...], aftësisë së kufizuar [...]*
 3. *Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tillë do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*”
15. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut bazohet në parimin themelor se të drejtat e njeriut bazohen në: “*dinjitetin e pandarë të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore*” dhe janë “*themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë.*”
16. Konventa Evropiane për Mbrotjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (më tej: Konventa) është dokument ligjor i zbatueshëm drejtëdrejt sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 22, paragrafi 2) dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Neni 14 i Konventës përcakton: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkage të tillë si seksji, raca, ngjyra, gjuha,*

feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo statusi tjetër.”

17. Ndërsa sipas nenit 1, paragrafi 2, të Protokollit Nr. 12, parashihet: “*Askush nuk mund të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.*”
18. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD), neni 1, paragrafi 1, përcakton: “*Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë [...], aftësisë së kufizuar[...].*”
19. LMD, në nenin 1, paragrafi 1, përcakton qëllimin e këtij ligji: “*Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.*”
20. Neni 3, paragrafi 1, i LMD-së përcakton: “*Parimi i trajtimit të pabarabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tertiortë sipas kuptimit të cilësdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.*” Ndërsa sipas paragrafit 2, shprehimisht thuhet: “*Diskriminim është çdo dallim, përvashim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvlefësoj ose cenoj njohjen, gjëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.*”
21. Neni 20, paragrafi 2, i LMD-së përcakton: “*Barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.*”
22. Ligji nr. 03/L-040 për Vetëeverisjen Lokale (LVL), neni 4, paragrafi 2, përcakton: “*Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t'i gjoznjë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngyre, gjinie, gjuhe, religioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gjoznjë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve.*”
23. Neni 17 [Kompetencat vetanake] përcakton: “*Komunat kanë kompetenca të plota dhe eksluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standarde e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:*
 - d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;*
 - i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;*
 - p) ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;*

s) çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër.”

24. Ligjin nr.04/L-110 për Ndërtim, nen 1 [Qëllimi], përcakton: “*Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kornizës ligjore e cila rregullon lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmérinë me kërkeshat e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda territorit të Republikës së Kosovës*”
25. Udhëzimit Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar, përkatësisht nenin 7 [Elementet Obligative për Qasje], pika 1), përcakton se “*1) Elementet obligative për qasje janë: A. elementet për qasjen në nivele me lartësi të ndryshme; B. elementet e qasjes për jetë të pavarur; C. elementet për qasje në komunikacion publik.*”

ANALIZA LIGJORE

26. Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i një vendi, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbijnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta, në nenin 21, paragrafi 3, shprehimisht përcakton obligimin e të gjithëve për respektimin e lirive dhe të drejtave të tjerëve. Prandaj ky parim është domosdoshmëri e kohës dhe duhet të respektohet nga të gjithë personat dhe organet, duke përfshirë këtu edhe qeverisjen komunale në Prishtinë.
27. Me Kushtetutë është përcaktuar përdorimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe i instrumenteve me të cilat garantohen të drejtat dhe liritë e njeriut, të cilat njëkohësisht paraqesin edhe kornizën ligjore ndërkombëtare, e cila është e nevojshme për luftën kundër diskriminimit. Instrumentet ndërkombëtare, të cilat zbatohen drejtpërsëdrejti në Kosovë, paraqesin pjesë të sistemit të brendshëm ligjor të Kosovës dhe kanë fuqinë, në rast të konfliktit, mbi të gjitha dispozitat ligjore dhe mbi aktet e tjera të institucioneve publike.
28. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj përcakton se gjëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim. Neni 14 vodos detyrime pozitive ndaj shteteve që të ndërmarrin masa për ta parandaluar dhe për ta hequr diskriminimin, kjo përfshin edhe nevojën që institucionet publike komunale t'i marrin në konsideratë nevojat e grupeve të veçanta.
29. Avokati i Popullit thekson se në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tej: Gjykata Evropiane). Gjykata Evropiane, si mekanizëm kryesor i Këshillit të Evropës për të mbrojtur të drejtat e njeriut, deri më tani ka konsideruar se e drejta (nenit 14) për të mos u diskriminuar në gjëzimin e të drejtave të garantuara nga Konventa është shkelur kur shtetet trajtojnë personat ndryshe në situata analoge, pa ofruar një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. E drejta për të mos u diskriminuar në gjëzimin e të drejtave të garantuara nga Konventa shkelet edhe kur shtetet, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, nuk arrijnë t'i trajtojnë ndryshe personat situatat e të cilëve janë dukshëm të ndryshme.

30. Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së (shih rastet *Kopecky v. Slovakia*, Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, para 45-52; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.)*, nr. 39794/98, para 73, GJEDNJ 2002-VII), “*pritja legitime*” duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore ose në akte ligjore.
31. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Enver Sahin kundër Turqisë*, ku një personi paraplegjik i pamundësohej qasja fizike në një ndërtesë të universitetit me qëllim të kryerjes së studimeve akademike, gjykata kishte vendosur sipas nenit 14 të Konventës në fjalë. Në këtë rast gjykata kishte deklaruar se shteti turk nuk duhej të mbetej thjesht pasiv, nuk mund ta neglizhonte vendosjen e çështjes lidhur me qasshmërinë e hyrjes në ambientet e universitetit për ankuesin dhe kërkonte masa pozitive për shtetin.
32. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se me Ligjin për Mbrojte nga Diskriminimi është themeluar një sistem gjithëpërfshirës i mbrojtjes nga diskriminimi në Republikën e Kosovës. Ky ligj e definon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim, kufizim apo dhënie e përparësisë, mbi çfarëdo baze, i cili ka për qëllim apo efekt që të sigurojë apo të trezikojë njojen, gjëzimin ose kryerjen e drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, të cilat janë të njoitura me Kushtetutë dhe me legjisacionin e aplikueshëm. Prandaj konsideron se Komuna e Prishtinës, në zbatim të ligjit, me prioritet duhet të ndërmarrë veprime konkrete për krijimin e kushteve të përshtatshme për lëvizje fizike për personat me aftësi të kufizuar, përfshirë qasjen e këtyre personave në vendbanim apo edhe qasjen në vende publike etj.
33. Të drejtat e njeriut janë të drejta absolute, të pandashme dhe mund të kufizohen vetëm me ligj. Institucionet duhet të tregojnë vullnet të mirë për përmirësimin e gjendjes, me synimin që të sigurojnë realizimin progresiv të të drejtave të njoitura me dispozitat ligjore. Ndërtesat, shërbimet publike dhe infrastruktura rrugore konsiderohen pa pengesa, nëse ato mund të përdoren nga personat me aftësi të kufizuara pa vështirësi të veçanta dhe, si rregull, pa ndihmën e të tjerve. Prandaj Avokati i Popullit shpreh shqetësimin se në komunën e Prishtinës, një pjesë të konsiderueshme e saj, lëvizja e pavarur në rrugë dhe në trotuare është pothuajse e pamundur për personat të cilët për mjete lëvizëse përdorin karroca me rrota.
34. Ligji nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në nenin 20, paragrafi 2, përcakton se barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë. Në këtë kuptim, gjykata gjatë shqyrimit gjyqësor të rastit në fjalë duhet ta detyrojë palën e paditur (Komunën e Prishtinës) që në përputhje me nenin 20 të LMD-së të paraqesë dëshmi që nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.
35. Për më tepër, Ligji për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë parashev edhe kompetencat vetjake, përkatësisht përcakton se komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjisacionin e zbatueshëm, në fushat e ndryshme, përfshirë edhe në zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe të hapësirës publike si dhe çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër. Avokati i Popullit konsideron se është përgjegjësi e Komunës së Prishtinës që t'u kushtojë vëmendje më të madhe akteve ligjore që kanë të bëjnë me çështjet

e ndërtimit, duke u përkujdesur që objektet të janë në pajtim me standarde të ndërtimit, duke u përkujdesur që t'i mirëmbajë vendet dhe hapësirat e tjera publike me qëllimin e vetëm: krijimin e mundësive të barabarta për lëvizje të të gjithë personave. Pra është kompetencë ekskluzive dhe e plotë që Komuna e Prishtinës në rastin konkret të ndërmarrë veprime me qëllim të mënjanimit të të gjitha pengesave të mundshme që mund të janë problematike për lëvizje të lirë për personat me aftësi të kufizuar, duke bërë paraprakisht një identifikim dhe studim të detajuar të hapësirave të tillë publike. Këto kërkesa janë të përcaktuara edhe në Ligjin nr.04/L-110 për Ndërtim, në të cilin është e përcaktuar korniza ligjore, e cila rregullon lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmërinë me kërkesat e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda territorit të Republikës së Kosovës.

36. Udhëzimi Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar, përkatësisht nenin 7 [Elementet Obligative për Qasje], pika 1), përcakton: “*1) Elementet obligative për qasje janë: A. elementet për qasjen në nivele me lartësi të ndryshme; B. elementet e qasjes për jetë të pavarur; C. elementet për qasje në komunikacion publik.*” Duke u bazuar në pretendimet e ankuesit, të cilat janë pjesë e padisë së parashtruar në GjThP, mungojnë kushtet fizike në trotuaret e Prishtinës dhe ka mungesë të qasjes fizike në to, ka pengesa fizike dhe bariera të tjera të ngritura përgjatë kalimit të rrugëve tek pjesët e shënuara për kalimin e rrugëve për këmbësorë (trotuare të ngritura), pengesa të tjera në hyrje të objekteve shëndetësore, përkatësisht Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Qendra”, që ia pamundësojnë ankuesit kryerjen e shërbimeve të nevojshme mjekësore dhe kjo gjendje, sipas pretendimeve të ankuesit dhe provave të parashtruara në IAP, janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar.

KONKLUSION

37. Personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht aftësive të tyre, kanë të drejta dhe nevoja për të cilat shoqëria, shteti dhe posaçërisht qeverisja lokale, duhet t'i përmbushin në bazë të konventave, të standardeve ndërkombëtare, si dhe të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës. Prandaj Avokati i Popullit konsideron se vetëm duke i zbatuar të gjitha këto obligime ligjore, personat me aftësi të kufizuara do të ndihen të vlerësuar, të barabartë dhe jo të diskriminuar në raport me qytetarët e tjerë. Trajtimi i barabartë është thelbësor për demokracinë, e cila është themeluar mbi parimin se çdo individ ka vlerë të barabartë.
38. Avokati i Popullit konstaton se mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar, në përputhje me nevojat e tyre specifike, përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar, të përcaktuar sipas nenit 1 të Ligji nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, si dhe është në kundërshtim me praktikat ndërkombëtare, përfshirë vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane.

39. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se Komuna e Prishtinës, me një angazhim dhe me një buxhet të përballueshëm, mund t'i rregullojë pjerrinat dhe të krijojë kushte të përshtatshme në Prishtinë për qasjen fizike për personat me aftësi të kufizuara, të cilat obligime dalin nga LMD, nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale si dhe nga Udhëzimi Administrativ nr.33/2017 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar.
40. Avokati i Popullit pohon se LMD-ja përcakton se barra e provës i bie palës së paditur, prandaj Komuna e Prishtinës duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë. Përcaktimi i lokacioneve në Prishtinë nga pala paditëse në gjykatë, që has në pengesa fizike dhe të cilat i konsideron që janë në kundërshtim me standartet ekzistuese të ndërtimit dhe me Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuar, përbën kufizim të qasjes fizike të ankuesit dhe të personave të tjera me aftësi të kufizuara, por në rastin konkret, Komuna e Prishtinës duhet t'i ofrojë informata GjThP-së, në atë mënyrë përmes së cilës do të vlerësohej situata ekzistuese e kushteve fizike për qasjen e personave me aftësi të kufizuar. Përndryshe, Komuna e Prishtinës ka qenë e obliguar paraprakisht të krijonte kushte të përshtatshme të bazë të kërkesave ligjore për qasje për personat me aftësi të kufizuar.



Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit